REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.11.2022)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:14 dhe mbaroi në orën 13:39.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
4. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
5. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
10. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Naureda Llagami***.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Maela Alicanaj, Këshilltare Ligjore pranë Njësisë Mbështetëse pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

3. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet mënyrë të përhershme", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).[1]

Çështja e cila është për trajtim në rendin e ditës së sotme datë 04.11.2022 lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Klodian Kurushi për të relatuar relacionet e përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Zoti Kurushi delegon zonjën Alicanaj që të vijojë me relatimin e të gjitha relacioneve për secilën nga kërkesat e paraqitura nga gjykatat që janë në nevojë.

Zonja Alicanaj merr fjalën duke parashtruar se nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës janë hartuar relacionet pas kërkesave të gjashtë gjykatave për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta.

Fillimisht propozohet radha e procedurave të shortit:

A. Gjykatat e shkallës së parë, sipas kësaj radhe:

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

B. Gjykatat e Apelit, sipas kësaj radhe:

I. Gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm:

1. Gjykata e Apelit Korçë;

2. Gjykata e Apelit Shkodër;

[1] Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

3. Gjykata e Apelit Vlorë.

Pasi anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime me radhën e procedurave të shortit, vijohet me relatimin e relacioneve përkatëse.

Për sa i përket kërkesës së ardhura nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës,** e cila ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë civile (lexohen të dhënat e çështjes që do t'i nënshtrohet procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Të gjithë gjyqtarët e gjykatës kanë paraqitur kërkesë për heqje dorë, të cilat janë pranuar me vendimet respektive.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme".

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes, në ndryshim nga rregulli i zakonshëm të mos përjashtohet nga shorti kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë: znj. Entela Shedula.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtari Artur Prenga.

Vijohet me kërkesat e **Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec**, e cila ka paraqitur nevojë në 2 çështje, në lënde penale (lexohen të dhënat e çështjeve që do t'i nënshtrohen procedurës së shortit sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme".

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2 (dy).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, në ndryshim nga rregulli i zakonshëm të mos përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, konkretisht: Z. Besnik Shehu.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Seladin Pysqyli dhe Eglantina Sofroni.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Seladin Pysqyli.

Vijohet me kërkesat e **Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër**, e cila ka paraqitur nevojë në 7 çështje, 5 në lëndë civile dhe 2 në lënde penale (lexohen të dhënat e çështjeve që do t'i nënshtrohen procedurës së shortit, sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme".

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 7 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 7 (shtatë) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2 (dy).

Për 7 (shtatë) çështje, për të cilat kërkohet në 6 raste nga 1 gjyqtar dhe në 1 rast 2 gjyqtarë të përzgjidhen me short 2 (dy) nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, konkretisht: Znj. Olkeda Lice.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e tjerë të cilët janë caktuar deri më tani nga KLGJ për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, Vlorë, Gjirokastër dhe Lushnjë, konkretisht: Sonila Hoxha, Alfred Konomi, Erlanda Agaj, Taulant Banushi.

Lidhur me sa më lart merr fjalën zonja Ukperaj e cila drejton pyetjen pse është përjashtuar nga shorti Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë në këtë rast?

Në përgjigje të sa më sipër, zonja Alicanaj sqaron se është vlerësuar ngarkesa e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, të cilët janë deleguar disa herë për të plotësuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, si dhe në një rast ishte e pamundur për t'u shortuar çështja në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, civile, gjyqtarja Gladiola Bregu.

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtarët Dajana Ndreja dhe Gladiola Bregu.

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarja Dajana Ndreja.

Për çështjen nr. 7, penale, gjyqtarja Gladiola Bregu.

Për çështjen nr. 4, civile, gjyqtarja Dajana Ndreja.

Për çështjen nr. 5, civile, gjyqtarja Gladiola Bregu.

Për çështjen nr. 3, civile, gjyqtarja Dajana Ndreja.

Vijohet me kërkesat e **Gjykatës së Apelit Korçë,** e cila ka paraqitur nevojë në 3 çështje, në lënde penale (lexohen të dhënat e çështjeve që do t'i nënshtrohen procedurës së shortit sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme".

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 (tre) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 (tre) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2 (dy).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: znj; {...}, si edhe znj. {...} për shkak të lejes së miratuar me vendim të kryetarit të gjykatës deri më 30.11.2022.

Zonja Ukperaj merr fjalën duke u shprehur se gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë në mënyrë periodike plotësojnë nevojat e Gjykatës së Apelit Korçë, sikundër ishte bërë edhe me rastin e Gjirokastrës, duhet të kishte edhe këtu një vlerësim të ngarkesës së gjyqtarëve. Në kushtet kur nuk është ky vlerësim nuk ka kundërshtim për të vazhduar por propozon që zonja {...} të përjashtohet nga lista e gjyqtarëve me arsyetimin se ajo është anëtare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe në periudhën dymujore që ka mbetur për plotësimin e mandatit ka ende procedura intensive për sa i përket plotësimit të pozicioneve të Gjykatës Kushtetuese dhe për shkak të këtij volumi pune, propozon që zonja {...} të përjashtohet nga lista e gjyqtarëve të cilët do t'i nënshtrohen shortit për përzgjedhjen e trupit gjykues.

Propozimi hidhet në votim si më poshtë: Përveç kryetares në detyrë të gjykatës së Apelit Tiranë dhe zonjës {...} e cila ka arsye shëndetësore, nga lista e gjyqtarëve që do t'i nënshtrohen shortit për zgjedhjen e trupit gjykues, të përjashtohet edhe zonja {...}.

Zonja Plaku është dakord.

Zoti Hallunaj është kundër.

Zoti Toro është kundër.

Zoti Hado është dakord.

Zonja Luli ngre pyetjen nëse zonja {...} ka bërë kërkesë për të mos marrë pjesë në këto shorte.

Zonja Ukperaj në përgjigje parashtron se asnjë gjyqtar që merr pjesë në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi nuk ka bërë kërkesë, vetëm në rastet kur kanë kërkuar ulje të ngarkesës. Gjithsesi në raste konkrete dhe kur ka pasur volum pune, janë përjashtuar edhe herë të tjera gjyqtarët e KED-së. Argumenton zonja Ukperaj se nisur nga afati 2-mujor dhe intensiteti i veprimeve që kryhen aty për efekt të plotësimit të vakancave, propozoi që zonja {...} të përjashtohej.

Zonja Luli shton në fjalën e saj se gjyqtarja nuk ka bërë as kërkesë për uljen e ngarkesës.

E konfirmon zonja Ukperaj që nuk ka bërë kërkesë për uljen e ngarkesës sepse ajo nuk ka qenë relatore e procedurave.

Lidhur me sa më lart zonja Luli shprehet që mos të merret në shqyrtim meqenëse nuk ka bërë kërkesë. Të mbahet i njëjti qëndrim për të gjithë dhe s'ka pse të veçohet zonja {...}. Është kundër.

Zonja Shehu është kundër.

Zonja Rupa është pro.

Zonja Ukperaj është pro.

Zoti Kurushi është kundër dhe argumenton si më poshtë:

Është e vërtetë që në disa raste janë bërë përjashtime për gjyqtarët të cilët ndodhen të ngarkuar dhe të përfshirë në KED, ashtu sikundër janë marrë në shqyrtim edhe kërkesa nga gjyqtarë që janë të përfshirë në po të njëjtin organ duke iu reduktuar pjesëmarrjen e tyre në short (siç ishte rasti i gjyqtares së shkallës së parë administrative Durrës, znj. Veizi). Kështu që, në

këtë rast, meqenëse nuk ka një kërkesë specifike nga zonja {...} anëtare e KED, vota e zotit Kurushi është kundër.

Zoti Rusi është pro propozimit të zonjës Ukperaj.

(Miratohet propozimi i zonjës Ukperaj për mospërfshirjen e zonjës {...} në procedurat e shortit.)

Anëtarët e Këshillit nuk kanë më diskutime apo kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarët Genti Shala dhe Irida Kacerja.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Genti Shala dhe Irida Kacerja.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Genti Shala dhe Irida Kacerja.

Vijohet me kërkesat e **Gjykatës së Apelit Shkodër**, e cila ka paraqitur nevojë në 5 çështje, 3 në lënde penale dhe 2 në lëndë civile (lexohen të dhënat e çështjeve që do t'i nënshtrohen procedurës së shortit sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Shkodër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme".

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 5 (pesë) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Durrës.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 5 (pesë) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3 (tre).

Për 5 (pesë) çështje, për të cilat në 4(katër) çështje kërkohet nga 1 (një) gjyqtarë dhe çështjen tjetër, kërkohen 3 (tre) gjyqtarë, të caktohen 3 (tre) të tillë, të cilët të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, përfshirë dhe gjyqtarin e skemës së delegimit të caktuar pranë saj.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, në ndryshim nga rregullim i zakonshëm të mos përjashtohet nga shorti Zv/Kryetari i Gjykatës së Apelit Durrës, konkretisht: z. Valbon Çekrezi; të përjashtohet z. Markelian Koça, në rastet ku ka pengesë ligjore, ose është aktualisht anëtar i trupit gjykues.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Valbon Çekrezi.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Markelian Koça.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarët Anita Mici (relatore), anëtarë Markelian Koça dhe Valbon Çekrezi.

Për çështjen nr. 5, civile, gjyqtare Anita Mici.

Për çështjen nr. 4, civile, gjyqtari Markelian Koça.

Vijohet me kërkesat e **Gjykatës së Apelit Vlorë**, e cila ka paraqitur nevojë në 1 çështje, në lënde penale (lexohen të dhënat e çështjes që do t'i nënshtrohen procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët Miranda Andoni. Ndërsa, znj. Adelajda Gjuzi shqyrton themelin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ndërsa gjyqtarët e tjerë ndodhen në papajtueshmëri dhe iu është pranuar kërkesa për heqje dorë.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Vlorë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme".

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastër, përfshirë dhe gjyqtarin e skemës së delegimit të caktuar pranë saj.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2 (dy).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të mos përjashtohet nga shorti zëvendëskryetarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastër, konkretisht: znj. Irena Brahimi.

Të përjashtohet znj. Miranda Andoni e cila është aktualisht anëtare e trupit gjykues.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Irena Brahimi dhe Arben Dosti.

Mbledhja deklarohet e mbyllur.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor